



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:077547

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749113

KPPP.nr. 1907/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Daci” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810423252 dhe seli në Pejë, kundër debitorit “Icon Frame” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811335985 dhe seli në Istog, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 304/22, i lejuar me datë 29.12.2022, nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Icon Frame” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811335985 dhe seli në Istog, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 304/22, i lejuar me datë 29.12.2022, nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 304/22, i lejuar me datë 29.12.2022, nga Përmbartuesi Privat Jeton Krasniqi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Daci” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 03/2022, e datës 04.04.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 304/22, të datës 29.12.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 23,600.00, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marrë vendimi përmbartues ose

urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Më tej, ka theksuar se fatura nuk përmban elementet të cilat duhet të plotësohen në kuptim të nenit 29.1 të LPP-së, sepse nuk dihet se kush e ka pranuar të njëjtën, konkretisht nga kush është nënshkruar, si dhe nuk përmban vulën e debitorit. Në fund ka theksuar se nga shkresat e lëndës vërtetohet se kreditori nuk ia ka dorëzuar debitorit urdhër ngarkesat dhe as faturat duke ia mohuar afatin për pagesë të faturës dhe eventualisht protesimin e së njëjtës. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor i ka të gjitha elementet të cilat përcaktohen sipas nenit 29, par. 2 të LPP-së, andaj e njëjta është e përshtatshme për përbarim. Gjykatës i ka propozuar që prapësimine debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhrin përbarimor ta lej në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se përbaruesi privat ka lejuar urdhrin përbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 03/2022, e datës 04.04.2022, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga

ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar dhe nënshkruar nga debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjtat i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata mori parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1907/23, datë 29.05.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.